

Informacione rreth mbrojtjes së të dhënave sipas nenit 13 të Rregullores për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (DS-GVO) në rast të dhënies së strehimit nga ana e qytetit të Köln-it – Zyra për çështje të banimit

Zyra për çështje të banimit, Ottmar-Pohl-Platz 1, 51103 Köln, ju ka strehuar në një banesë për raste urgjente, në një strehimore apo njësi tjetër banimi. Në kuadër të strehimit tuaj jemi të detyruar të marrin shënim të dhënat tuaja personale si emtin dhe datëlindjen tuaj. Këto të dhëna ne do t'i ruajmë dhe do t'ua përcjellim edhe zyrave të tjera të qytetit të Köln-it dhe personave të tretë dhe t'i përpunojmë më tej.

Ne të dhënat tuaja personale i përpunojmë vetëm mbi bazë të normave përkatëse ligjore. Baza ligjore për përpunimin e këtyre të dhënave është një rregullore e Parlamentit Evropian e quajtur Rregullorja për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (DS-GVO) si dhe Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i landit Nordrhein-Westfalen (DSG NRW).

Përmes kësaj shkrese ne dëshirojmë t'ju informojmë rreth fakteve më të rëndësishme dhe të drejtave tuaja në bazë të DS-GVO.

Emri dhe të dhënat e kontaktit të personit përgjegjës

Qyteti i Köln-it (Stadt Köln) – Kryetarja e Bashkisë (Die Oberbürgermeisterin) Zyra për çështje të banimit, drejtori (Amt für Wohnungswesen, Amtsleitung), Ottmar-Pohl-Platz 1, 51103 Köln Postfach (kutia postare) 10 35 64, 50475 Köln, Email: wohnungsamts@stadt-koeln.de, telefoni 0221-221-23903, telefaksi 0221-221-23100.

Të dhënat e kontaktit të personit të autorizuar për mbrojtjen e të dhënave personale

I autorizuari zyrtar i qytetit të Köln-it ka adresën: Stadt Köln, Datenschutzbeauftragter der Stadt Köln. Stadthaus Deutz – Ostgebäude, Willy-Brand-Platz 3, 59679 Köln. Adresa e tij e email-it është datenschutzbeauftragter@stadt-koeln.de, telefoni 0221-221-22457 ose 0221-221-22509.

Synimi dhe baza ligjore e përpunimit të të dhënave

Në bazë të nenit 6 paragrafi 1 fjalia 1 lit. C të DS-GVO, në lidhje me nenin 2 të Ligjit të Landit për strehimin dhe pranimin e refugjatëve të huaj (FlüAG NRW) ne si komunë jemi të detyruar të pranojmë dhe strehojmë refugjatë.

Si autoriteti për sigurimin e rendit në kuadër të parandilimit të rreziqeve neni 14 i Ligjit për organet e rendit i gëzojmë kompetencat për strehimin e personave pa banesë dhe pa strehë. Që të mund të përmbushim këtë detyrë dhe të mund të planifikojmë, drejtojmë, të financojmë si dhe të koordinojmë strehimet, është i nevojshëm përpunimi i të dhënave tuaja private (neni 6 paragrafi 1 fjalia 1 shkronja e DS-GVO).

Cilat të dhëna përpunohen?

Në kuadër të strehimit tuaj në bazë të normave publike dhe ligjore qyteti i Köln-it – Zyra për çështje të banimit – përpunon të dhënat e mëposhtme tuajat si dhe ato të fëmijëve tuaj të mitur:

- Mbiemri, mbiemri i lindjes dhe emri (për identifikim)
- Datëlindja (për identifikim si dhe strehim në përputhje me moshën)
- Gjinia (për identifikim si dhe strehim në përputhje me gjininë përkatëse)
- Nënshetësia dhe shteti i origjinës (për drejtimin dhe planifikimin e strehimit tuaj)
- Statusi juaj i qëndrimit (për të llogaritur shpenzimet e strehimit)
- Adresa e banimit (për plotësimin e detyrimit të lajmërimit zyrtar)
- Nevoja personale si psh. shëndeti dhe feja (për respektimin dhe mbrojtjen e këtyre nevojave)

Kush i pranon të dhënat personale?

Të dhënat tuaja iu dërgohen në kuadër të kompetencave ligjore insitucioneve, organizatave dhe personave të mëposhtëm nëse ato janë të inkuadruara në strehimin tuaj:

- Zyra për çështje sociale, të punës dhe të moshuarit (dhënia e ndihmës sociale)
- Jobcenter Köln (dhënia e ndihmës sociale)
- Zyra për çështje të fëmijëve, të rinjve dhe familjeve (ndihmë dhe këshillime për të rinj dhe familje)
- Zyra e arsimit (detyrimi për të ndjekur shkollën)
- Zyra për çështje të shëndetësisë, mjekët përkatës (trajtimi dhe kujdesi mjekësor)
- Zyra për integrim dhe shumëllojshmëri (këshillime rreth çështjeve të integrit)
- Shërbimi për qytetarë (detyrimi për lajmërim zyrtar)
- Zyra për çështje të të huajve (e drejta e qëndrimit)
- Kompani të sigurimit (detyra e tyre për mbikqyrje)
- Bartës të çështjeve të kujdesit (kujdesi social)
- Shoqata dhe persona të angazhuar vullnetar (shoqërim integrativ)
- Kompani të ndryshme shërbimesh (riparime dhe mirëmbajtje të banesave)

Të dhënat e dërguara nga palët e treta mund të përdoren vetëm për qëllimet e përmendura. Nëse e kërkon një gjë të tillë, atëherë ne do t'ju japim informacione më konkrete.

Sa kohë ruhen të dhënat tuaja?

Ne jemi të detyruar që të fshijmë menjëherë të dhënat të dhënat tuaja personale në momentin që ato nuk janë më të nevojshme për strehimin tuaj (neni 17 paragrafi 1 fjalia 1 lit. A të DS-GVO). Të dhënat tuaja personale do të fshihen menjëherë nga ana jonë, sapo të kenë skaduar afatet ligjore të parapara në rregulloren e qytetit të Köln-it të datës 9 mars 2018. Afati për ruajtjen e të dhënave tuaja skadon pas pesë vjetësh dhe rifillon nëse nevojitet një strehim i sërishëm. Brenda këtij afati nuk keni të drejtë të kërkonit fshirjen e parakohshme sipas nenit 17 DS-GVO.

Cilat të drejta ligjore keni ju si person i prekur?

Si person i prekur rregullorja DS-GVO ju jep këto të drejta:

- Një miratim i dhënë njëherë, mund të tërhiqet nga ju prapa kurdo që të dëshironi (neni 7 paragrafi 3 DS-GVO)
- Keni të drejtë të kërkonit informacion rreth të dhënave tuaja të përpunuara nga ne (neni 15 DS-GVO)
- Korrigjimin dhe plotësimin e menjëhershëm të të dhënave tuaja të gabuara ose jo të plota (neni 16 DS-GVO)
- Fshirjen e të dhënave tuaja personale duke u bazuar në nenin 17 të DS-GVO
- Kufizimi i përpunimit të të dhënave sipas nenit 18 DS-GVO
- Të drejta të tjera, të parapara në nenin 20 DS-GVO (e drejta për kalimin e të dhënave) si dhe nenin 21 DS-GVO (e drejta e ankesës)

Këto të drejta mund të kufizohen duke u bazuar në nenin 23 të DS-GVO. Legjislativi i Landit e ka shfrytëzuar mundësinë e paraparë në nenin 12-14 të DSG-NRW për kufizimin e të drejtave të personave të prekur. Nëse ju dëshironi të shfrytëzoni një prej këtyre të drejtave, atëherë ne do të shohim se a është kërkesa juaj në përputhje me ligjin.

Të dhënat e kontaktit të të autorizuarit për çështje të mbrojtjes së të dhënave
Ankesat rreth punës tonë në çështjet e të dhënave personale drejtojeni tek:

Landesbeauftragte für Datenschutz und Informationsfreiheit Nordrhein-Westfalen
Postfach 20 04 44
40102 Düsseldorf
Telefon 0211 / 38424-0
ose Email: poststelle@ldi.nrw.de

Gjendja në shtator 2020